



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:217876  
Datë: 29.04.2024  
Numri i dokumentit: 05634606

CAP.nr.1470/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren individuale Hidajete Gashi Alaj, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit S.D nga Rahoveci, të cilën e përfaqëson shoqëria e avokatëve “L. Sh.P.K.”, me av. N.S nga Prishtina, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër debitorit Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, për pagesën e borxhit në emër të shujtave ditore dhe kompensimit të pagës jubilarë, duke vendosur në lidhje me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë -Dega në Rahovec, PPP.nr.76/2020, i datës 20.03.2023, me datë 29.04.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e debitorit Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë - Dega në Rahovec, PPP.nr.76/2020, i datës 20.03.2023 ANULOHET dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin PPP.nr.76/2020, i datës 20.03.2023, ka vendosur si në vijim:

*“I.REFUZOHET TËRËSISHT SI I PA BAZUAR, prapësimi i debitorës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, i paraqitur kundër urdhërit të përmbaruesit privat S.K në Suharekë P.nr. 223/2020 i datës 10.09.2020, me të cilin është lejuar përmbarimi sipas propozimit të kreditorës S.D nga Rahoveci, në bazë të dokumentit të përmbarues – vendimit të inspektoriatit të punës në MPMS – IP – Gjakovë, me nr. 644/2020, i datës 30.06.2020, ashtu që MBETET NË FUQI urdhëri me të cilin është lejuar përmbarimi, për borxhin në shumën prej 1.624,00 (njëmijë e gjashtëqind e njëzet e katër euro e zero cent) Euro;*

*II.DETYROHET debitorja Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, që t’ia paguaj kreditores në emër të 50% të një page jubilarë shumë prej 250,61 (dyqind e pesëdhjetë euro e gjashtëdhjetë e një cent) Euro, si dhe në emër të kompensimit të ushqimit në punë – shujtave, për 687 ditë të punës nga 2,00 Euro, shumë prej 1,374.00 (njëmijë e treqind e shtatëdhjetë e katër euro e zero cent) Euro, në bazë të vendimit të inspektoriatit të punës në MPMS – IP – Gjakovë, me nr. 644/2020, i datës 30.06.2020, në shumë e përgjithshme totale prej 1.624,00 (njëmijë e gjashtëqind e njëzet e katër euro e zero cent) Euro, me kamatë ligjore në larësin prej 8 %, nga dita e paraqitjes së propozimit për përmbarrim më datë 10.09.2020, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej shtatë (7) ditësh nga nxjerrja e këtij aktvendimi; ”.*

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor, ankesë ka paraqitur debitori për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave të LPP-së, po ashtu edhe të LPK-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovoj ankesën, ashtu që aktvendimin e atakuar ta anulojë, duke i shfuqizuar të gjitha veprimet e kryera të deritanishme përmbarrimore apo lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje ose vetë gjykata e shkallës së dytë të vendosë, duke e refuzuar propozimin për përmbarrim.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur kreditori, përmes të autorizuarit të saj, duke e kundërshtuar në tërësi ankesën e debitorit, me propozim që e njëjta të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktvendimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjyqtarja individuale e Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas shqyrtimit të tyre, konform nenit 3 paragrafi 2 të Ligjit të Procedurës Përmbarrimore si dhe në kuptim të nenit 194, 208 dhe 209 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka paraqitur propozim për përmbarrim me datë 10.09.2020 ndaj debitorit, në bazë të Vendimit të Inspektoratit të punës, numër Nr.644/2020, dt. 30.06.2020.

Përmbarruesi Privat, me urdhrin P.nr.223/20, i datës 10.09.2020, ka lejuar përmbarrimin.

Kundër Urdhërit për caktimin dhe lejimin e përmbarrimit, brenda afatit ligjor prapësim ka paraqitur debitori duke e kundërshtuar në tërësi si për nga baza edhe për nga vlera propozimin e kreditorit si të pa bazuar, të pa rregullt dhe si të tillë të palejueshëm, sepse i mungon baza juridike dhe ligjore po edhe të vetë mungesës së titullit ekzekutiv përmbarrimor, sepse nuk i ka tiparët e dokumentit përmbarrues sipas nenit 22 paragr. 1 nënparagr. 1.2 e lidhur me nenin 24 paragr. 3 të LPP. andaj gjykatës i ka propozuar që të aprovohet prapësimi si i bazuar dhe të anulohet urdhri përmbarrimor ose që të caktohet seanca dëgjimore konform nenit 73 të LPP. lidhur me nenin 12 të Ligjit për ndryshimet dhe plotësimet e LPP-së. Shpenzimet nuk i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë me pas shqyrtimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin, PPP.nr.76/2020, i datës 20.03.2023, me të cilën e ka refuzuar si të pabazuar

prapësimin e debitorit duke e lënë në fuqi urdhrin e përmbaruesit privat, më decidivisht si në dispozitivin e të njëjtit.

Në arsyetim të aktvendimit të shkallës së parë gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pretendimet e debitorit në prapësim, se në këtë rast dokumenti në bazë të së cilit është lejuar përmbarimi është i papërshtatshëm për përmbarim dhe i mungojnë vetit e dokumentit përmbarues, i ka marrë si të pabazuara, për shkak se detyrimi i krijuar me vendimit të inspektoratit të punës në MPMS – IP – Gjakovë, me nr. 644/2020, i datës 30.06.2020, në shumën prej 1.624,00 (njëmijë e gjashtëqind e njëzet e katër euro e zero cent) Euro, i përmbush në plotësi kriteret e kërkuara në nenin 27 parag. 1 të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore. Kështu që kësaj dispozite edhe vetë debitori me anë të prapësimit i është referuar, ndërsa kur kemi parasysh që dokumenti i përmbarues në bazë të cilit është iniciuar procedura përmbarimore është vendimit të inspektoriatit të punës në MPMS – IP – Gjakovë, me nr. 644/2020, i datës 30.06.2020, i cili i përmbushen të gjitha kriteret e kërkuar në dispozitën e lartcekur. Për këto arsye gjykata ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Gjykata e shkallës së parë tutje ka theksuar se në këtë rast ka zbatuar nenin 17 të LPP-së, përshtatshmërisht me nenin 144 parag. 1 nënparag. 3 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, prandaj ky dokument përmbarues, respektivisht vendimi i inspektoriatit të punës në MPMS – IP – Gjakovë, me nr. 644/2020, i datës 30.06.2020, është bërë i ekzekutueshëm në të njëjtën ditë në të cilën edhe është nxjerr, për çka gjykata vlerëson se debitori në pretendimet e tij në prapësim i kishte të pa mbështetur në prova, fakte apo në shkelje ligjore të argumentuara. Ndërsa për të vendosur në lidhje me prapësimin e debitorit gjykata mori për bazë nenin 69 parag. 4 të LPP-së, i cili thotë se: *“Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”*, për çka debitori nuk e ka mbështetur me prova, fakte apo shkelje të normave prapësimin e të cilat do të ndikonin që gjykata të marrë vendim ndryshe nga ajo që ka vendosur në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Pretendimet e kreditores se në këtë rast dokumenti përmbarues në bazë të së cilit është lejuar përmbarimi, qëndrojnë për arsye se gjykata e shkallës së parë i ka gjetur që i njëjti është konform dispozitave ligjore të cituara më lartë. Ndërsa pretendimet e debitorit në prapësimin e tij, se propozimi për përmbarim nuk është i lejuar dhe se dokumenti është i papërshtatshëm për përmbarim, nuk e qëndrojnë dhe nuk e lirojnë të njëjtin nga detyrimet për pagesën e detyrimeve ndaj kreditorit. Gjykata me qëllim të ekonomizimit të procedurës gjyqësore, nuk ka caktuar ekspertizë, por që llogaritjet në lidhje me lartësinë e shumës të cilat debitori ka detyrim ndaj kreditorit, i ka bërë në këtë mënyrë (52 javë viti, secila javë ka 5 ditë pune, prej tyre ka hequr 11 ditë të festave zyrtare çdo vit si dhe ka zbritur 20 ditë pune pushim vjetor çdo vit, ku kemi arritur që ta nxjerrim përfundimin se gjatë një viti kalendarik ka 229 ditë pune, e pastaj kemi shumëzuar me 3 vite për periudhën 18.04.2017 e deri më 17.04.2020, kemi përfitur ditët totale të punës 687 ditë pune për 3 vite), ku në emër të 50 % të një page jubilarë shumën prej 250,61 Euro, si dhe në emër të ushqimit në punë – shujtave për 687 ditë nga 2,00 Euro (687\*2.00 € = 1,374.00 Euro), shumën prej 1,374.00 Euro, e që në shumën e përgjithshme totale lartësinë prej 1,624.00 Euro, për të cilat gjykata ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Gjykata vendosi që ta refuzoj në tërësi prapësimin e debitorit dhe ta lë në fuqi urdhrin e përmbaruesit privat, duke u bazuar edhe në dispozitat e LPP-së, nenin 29 paragrafi 3, e që në këtë rast janë përmbushur në plotëni këto kërkesa ligjore. Andaj, gjykata ka ardhur në përfundim se pretendimet e debitorit të cekura në prapsim, nuk janë bazë e mjaftueshme, e as pengesë për lejimin e përmbarimit në rastin konkret, lidhur me propozimin e kreditorit për detyrimet në bazë të dokumentit përmbarues – vendimit të organit administrative/inspektoriatit të punës në Gjakovë, ashtu që gjykata nuk mori për bazë thëniet dhe pretendimet tjera të cilat do të kishin impakt për të vendosur ndryshe nga dispozitivi i këtij aktvendimi.

Gjykata ka vendosur lidhur me kamatën ligjore në lartësi prej 8% konform nenit 382 të LMD-së.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata e Apelit nuk e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1 lidhur me nenin 27 dhe 38 të LPP-së, nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë gjendja faktike, si dhe kemi zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Gjykata e Apelit duke i vlerësuar pretendimet ankimore të palës debitore gjen se të njëjtat janë të themelta pasi që edhe pse kjo Gjykatë gjen se propozimi për përmbarim është bërë në bazë të dokumentit përmbarimor –vendimit administrativ, Gjykata e shkallës së parë ka dështuar që të vlerësojë faktin se a i përmbush ky dokument kërkesat ligjore për tu konsideruar si i përmbarueshëm, më konkretisht ka dështuar që të vlerësojë përshtatshmërinë e përmbarimit të këtij dokumenti.

Neni 22 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 i Ligjit për Procedurën Përmbarimore përcakton se: *“1. Dokumente përmbaruese janë: “1.2. vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (më tej: ujdia);”*

Neni 23 paragrafi 2 i Ligjit për Procedurën Përmbarimore përcakton se: *“2. Vendim i organit administrativ, sipas këtij ligji konsiderohet vendimi dhe konkluzioni i dhënë në procedurë administrative nga organi ose shërbimi administrativ apo nga personi juridik i ngarkuar me autorizime publike, kurse aktpajtim administrative konsiderohet ujdia e arritur në procedurën administrative përpara organit ose shërbimit, përkatësisht personit juridik të tillë, po qe se ka të bëjë me detyrimin në të holla dhe po qe se me ligj nuk është paraparë diçka tjetër.”*

Ndërsa me nenin 27 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore përcaktohet se: *“1. Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit. 2. Në qoftë se me anë të dokumentit përmbarues nuk është caktuar afati për përmbushje vullnetare të detyrimit, afati i tillë do të caktohet me anë të aktvendimit për përmbarimin, dhe urdhrin për përmbarim, për shtatë (7) ditë. 3. Në rastin nga paragrafi 2. i këtij neni, organi përmbarues e cakton*

*përmbardimin e propozuar nëse debitori brenda afatit që i është caktuar për përmbushje vullnetare nuk e përmbushë detyrimin e tij.”*

Në këtë çështje juridike përmbardimore, Gjykata e Apelit vlerëson se aktvendimi i Gjykatës së shkallës së parë është marrë në shkallë të dispozitave të sipërcituara dhe atë për faktin se nga Vendimi i Inspektoratit të Punës, nr.644/2020, i datës 30.06.2020, më konkretisht në dispozitivin e këtij aktvendimi vetëm përmendet një shumë prej 2,00 eurove si dhe lartësia prej 50% e shumës prej 250.61 euro për vitet e shërbimit në punë, mirëpo dokumenti si i tillë nuk i përmbush kushtet për të qenë i përmbardueshëm, pasi që në procedurën përmbardimore, për të qenë një vendim i ekzekutueshëm duhet të përcaktohet shuma konkrete e cila duhet të përmbushet si dhe koha e përmbushjes është detyrimit, e që në rastin konkret këto dy elemente thelbësore mungojnë në dokumentin që është kërkuar që të përmbardohet.

Gjykata e Apelit vë në pah faktin se jo çdo dokument që është i përcaktuar me dispozitat e LPP-së si titull ekzekutiv duhet të lejohet përmbardimi në raport me të, pasi që fillimisht pasi që të vërtetohet se a ekziston baza juridike për përmbardim duhet të vërtetohet fakti se a i plotëson kushtet që dokumenti të jetë i përmbardueshëm, pasi që sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit jo çdo dokument mund të jetë i përmbardueshëm përkundër faktit se është titull ekzekutiv.

Kjo Gjykatë vlerëson se në rastin konkret Gjykata e shkallës së parë ka vepruar përtej kompetencave të veta që i ka pasur në procedurën përmbardimore, ashtu që vetë i ka llogaritur ditët e pranisë në punë si dhe vitet jubilarë, e që Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret Gjykata në procedurë përmbardimore duhet të ketë parasysh parimin e rigorozitetit formal, ashtu që Gjykata veç është dashur që të vërtetojë se a është i përshtatshëm dokumenti për tu përmbarduar apo jo dhe të marrë vendimin meritor lidhur me të.

Në rastet kur debitori e atakon procedurën e përmbardimit si jo të rregullt apo ligjore, si dhe kur e atakon dokumentin përmbardimor, nuk ka nevojë të provohet me prova një kundërshtim i tillë, por gjykata në raport me këto pretendime është dashur që të jep sqarime se a përmbushen të gjitha kushtet për tu proceduar më tutje ashtu siç e përcakton edhe Ligji për Procedurën Përmbardimore.

Në ri-procedurë, gjykata e shkallës së parë duhet të veprojë në kuptim vërejtjeve të sipërpërmendura, ashtu që fillimisht të veprojë në përpikëri në pajtim me dispozitat ligjore të caktuara në procedurën e përmbardimit, me rastin e vlerësimit të propozimit për përmbardimit, të vërtetojë si duhet gjendjen faktike, të vlerësojë se a përmbushen kushtet e përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbardimore në kuptim të përshtatshmërisë së dokumentit, të vlerësojë pretendimet e debitorit në prapësim, e në veçanti ti vlerësojë edhe njëherë shkaqet nga neni 71 të LPP-së, e pas kësaj të marrë vendim meritor, të drejtë dhe të ligjshëm duke i zbatuar dispozitat ligjore në fuqi.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në nenin 3 paragraf 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Numri i lëndës: 2021:217876  
Datë: 29.04.2024  
Numri i dokumentit: 05634606

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika d) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
CAP.nr.1470/2023, të datës 29.04.2024

Gjyqtarja  
Hidajete Gashi Alaj, d.v.